

VENDIM
Nr.43, datë 31.5.2010

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR SHOQËRISË
“FABRIKA E ÇIMENTOS FUSHË-KRUJË” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 4 dhe 5 pika 2 të “Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006, dhe ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.17, datë 6.3.2009, bordi i komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.5.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Fabrika e çimentos Fushë-Krujë” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar, konstatoi se:

Aplikimi plotëson kërkesat e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar dhe vendimit nr.8, datë 29.1.2010 të bordit të komisionerëve “Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar për vitin 2010”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënie e statusit të klientit të kualifikuar shoqërisë “Fabrika e çimentos Fushë-Krujë” sh.p.k.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta